60.			<b>11. Popullimi, kultura dhe zhvillimi ekonomik në Azinë Juglindore</b>	<p><b>Situata 39:</b> Bazuar në njohuritë e marra për pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të Azisë Juglindore, vlerësoni rolin e tyre në zhvillimin ekonomik të këtij</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;</p>	<p>-Vlerësim me gojë;</p>	
61.							

62.	shpërndarjes hapësimore të ekonomisë së këtij rajoni.	12. Punë praktike 8: - Rajoni i Azisë Lindore dhe rajoni i Azisë Juglindore	rajon.	Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role.	-Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shëpësisë; -Vlerësim i gjeografike dhe politike të botës. Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi	Teksti i gjeografisë Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës. Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi
	• Përzgjedh informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e interpreton atë.	13. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Azisë Jugore	<b>Situata 40:</b> Dimë që Himalajet janë malet më të larta në botë. Bazuar në njohuritë tuaja dhe në hartën fiziko-gjeografike të paraqitur në klasë, përcaktoni shtrirjen gjeografike të tyre dhe përshkruani disa veçori.			
63.	• Interpretim me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.	14. Popullimi, kultura dhe zhvillimi ekonomik në Azinë Jugore	<b>Situata 41:</b> Nënë Tereza është e njohur në gjithë botën për përkushtimin dhe ndihmën e saj ndaj njerëzve në nevojë. Pjesën më të madhe të punës së saj bamirëse e kreu në Kalkuta të Indisë, prej nga mori edhe emrin “Nënë Tereza e Kalkutës”. Çfarë dini për veprimtarinë e saj në Indi? Me	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;	Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.	Teksti i gjeografisë
	• Identifikon dhe interpreton në hartë veçoritë fiziko-gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë.					
64.	• Identifikon veçoritë e popullimit dhe				-Vlerësim me gojë;	Teksti i gjeografisë

		kulturës së këtij rajoni. ● Dallon tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni. ● Përzgjedh informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e interpreton atë.		çfarë problemesh përballej popullsia e Indisë e asaj periudhe? Po sot?	Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role.	-Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpësisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Hartat fiziko-geografike dhe politike të botës. Hartat fiziko-geografike dhe politike të Evropës.  Materiale nga interneti, libra, enciklopedi  Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video  Materiale të përgatitura me power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
65.	<b>15. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Australisë dhe të Oqeanisë</b>			<b>Situata 42:</b> Rajoni i Australisë dhe i Oqeanisë është një hapësinë interesante për botën e gjallë që rritet në të. Bazuar në informacionet që keni marrë nga burime të ndryshme (dokumentarë, enciklopedi, revista etj.), a mund të evidentoni disa veçori të bimbësisë dhe të botës shtazore të këtij rajoni?			
66.	<b>16. Popullimi, kultura dhe zhvillimi ekonomik në Australi dhe Oqeani</b>			<b>Situata 43:</b> Pozita gjeografike dhe relievi kanë ndikuar shumë në popullimin e rajonit të Australisë dhe të Oqeanisë. Sipas që keni marrë nga burime të ndryshme, çfarë dini rreth popullimit më të hershëm të rajonit apo rreth ndikimeve			

[illegible]



### ➡ II.3 Disa modele të planifikimit të një ore mësimore (modele skematike)

**Shënim:** Edhe pse në planifikimet e mëposhtme ditore të orëve mësimore, janë paraqitur për çdo orë, rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe nuk është detyrim që brenda një ore mësimore ato të realizohen të gjitha (të shtata kompetencat), por vetëm disa prej tyre. Paraqitja e plotë e tyre e pasqyruar në çdo orë mësimore, është bërë:

- për shkak të respektimit të formatit të një ore mësimore;
- me qëllim paraqitjen në të, të çdo detaji që do të ndihmonte në orientimin e punës së mësuesit;
- për të paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pritshmëritë që mund të ketë secila prej orëve mësimore.

#### **Nëntematika I – Rajonet dhe rajonizimi (6 orë)**

Në përfundim të kësaj nëntematike, nxënësi/ja:

- Shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese.
- Përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.
- Identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë.
- Lokalizon në hartë dhe interpreton rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë.
- Interpretë grafikë, diagrame etj., që përshkruajnë dinamikën e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.
- Prezanton dhe komunikon përmes hartës së botës shpërndarjen hapësinore të besimeve më të mëdha fetare dhe gjuhëve kryesore.
- Bën dallimin ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë (shoqëruar me interpretimin në hartë);
- Sjell shembuj të bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve në aspektin ekonomik, politik, kulturor, mjedisor etj.

## ➔ Tema mësimore: I.1 Rajonet dhe veçoritë e tyre

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: IV</b>	<b>KLASA: VIII</b>
<b>Nëntematika I: Rajonet dhe rajonizimi</b>		<b>Tema mësimore: I.1 Rajonet dhe veçoritë e tyre</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese.		<b>Fjalët kyçe:</b> rajonet, veçoritë e rajoneve	
<b>Burimet:</b> Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, qytetari, histori, TIK	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<b><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.</li><li>Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth veçorive të rajoneve.</li><li>Përshkruan veçorive të rajoneve, duke analizuar figurat 1, 2, 3 dhe 4.</li></ul>			
<b><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Jep shembuj të ngjashëm ilustrues mbi veçoritë e rajoneve, bazuar në ato që paraqiten si modele në libër.</li><li>Shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese.</li></ul>			
<b><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.</li></ul>			
<b><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.</li></ul>			
<b><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Ndan mendimet në grup.</li></ul>			
<b><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit shoqëror.</li></ul>			
<b><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rajonet dhe veçoritë e tyre.</li></ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<b><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Nxënësi përcakton kuptimin mbi rajonin dhe përshkruan veçoritë e rajoneve, duke analizuar figurat 1, 2, 3 dhe 4.</li></ul>			
<b><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Nxënësi hulumton, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi rajonet dhe veçoritë e tyre.</li></ul>			
<b><u>3. Marrja e vendimeve</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Nxënësi analizon se ç'janë rajonet dhe përcakton veçoritë e tyre.</li></ul>			

<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></p>	<p>Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në njohuritë e marra nga nxënësit në klasën e gjashtë mbi rajonet.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1.</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I : Rrjeti i diskutimit</b> - Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1 në tekst: <b>Diskutojmë:</b> <i>Kujtoni se çfarë keni mësuar në Gjeografinë 6 mbi vendin e rajonin dhe shpjegoni kuptimin e secilit prej tyre. Në hartat e paraqitura në klasë, identifikoni dhe qarkoni disa prej rajoneve që njihni, duke argumentuar pse janë klasifikuar si si të tillë.</i> Nxënësit përshkruajnë, përkufizojnë,.... Mësuesi/ja vazhdon: Njeriu është përpjekur që herët ta njohë dhe ta studiojë botën ku jeton, pasi i është dashur ta transformojë vazhdimisht mjedisin e saj fizik. Me kalimin e kohës, natyra e ndërveprimit të tij me mjedisin fizik ka ndryshuar dukshëm nga kultura në kulturë. Duke qenë se studimi i të gjithë hapësirës ku jetojmë është i vështirë, gjeografët e ndajnë atë në njësi më të vogla, të quajtura <i>rajone</i>. Shkenca që studion veçoritë e rajoneve quhet <i>gjeografi rajonale</i>. <i>Rajoni është njësia e sipërfaqes së tokës që karakterizohet nga tipare fizike ose veçori të aktivitetit njerëzor qartësisht të dallueshme nga të tjerat.</i> Kështu, një grup vendesh me tipare fizike, kulturore, ekonomike, historike etj., të ngjashme apo të përafërta midis tyre mund të përfaqësojnë një rajon.</p> <p>- Mësuesja u drejtohet nxënësve me pyetjen që nxit brainstorming-un: Çfarë dini për secilin prej tyre? Jepni nga një shembull.</p> <p>- Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve ... Mësuesi/ja vazhdon: Rajone përbëjnë p.sh.: grupimet e vendeve me tipare të njëjta të klimës apo të relievit; me dialekte të ngjashme, me tradita të njëjta në muzikë, kulinari, në prodhimin e verës, apo edhe grupimet e vendeve që ndajnë përvoja të përbashkëta historike etj. Rajonet karakterizohen nga disa veçori të rëndësishme...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b> Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë figurat 1, 2, 3 dhe 4 dhe u kërkon nxënësve t'i përshkruajnë veçoritë e rajoneve së bashku me të, duke interpretuar hartat e paraqitura në këto figura.</p>

	<b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</b> Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të tekstit, në rubrikën “Radha jote”.
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre: shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese dhe japin modele.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## ➔ Tema mësimore: I.2 Llojet e rajoneve

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: IV	KLASA: VIII
Nëntematika I: Rajonet dhe rajonizimi		Tema mësimore: I.2 Llojet e rajoneve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.</li><li>Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi llojet e rajoneve.</li></ul>			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.</li><li>Identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë.</li></ul>			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.</li></ul>			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.</li></ul>			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Ndan mendimet në grup.</li></ul>			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.</li></ul>			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tipat e rajoneve.</li></ul>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
Nxënësi identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë.			
Përshkuan llojet e rajoneve.			

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi interpreton veçoritë që i dallon secilin prej tyre.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvlerësimit midis vendeve dhe rajoneve.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:**

Nxënësi/ja përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvlerësimit midis vendeve dhe rajoneve. Identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë.

**Fjalët kyçe:** rajonet fizike, rajonet kulturore

**Burimet:** Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve****a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Nxënësit dinë:

a. Ç'është rajoni dhe veçoritë e rajoneve.

**Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

**Veprimet në situatë****Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 në tekst: **Diskutojmë:** *Në hartat e Republikës së Kosovës paraqiten dy ndarje rajonale të ndryshme të territorit të saj. Përcaktoni llojin e secilës hartë dhe çfarë rajonesh paraqesin ato.*

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...

**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**

Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë rajonet fizike: Gjeografët i përcaktojnë rajonet në mënyra të ndryshme, në varësi të qëllimit dhe të kriterëve të përdorura për rajonizimin e hapësirës. Kur një hapësirë rajonizohet duke u bazuar në karakteristikat fizike të saj (relievi, klima, bimësia, ujërat etj.), rajoni i formuar quhet *rajon fizik*. Shembuj të rajoneve fizike janë kontinentet, rajonet (zonat) klimatike të botës, brezat e bimësisë, Himalajet, Alpet e Evropës, pyjet e lagështa tropikale të Amazonës, shkretëtirat etj.

Mësuesja fton nxënësit të përshkruajnë figurat 1 dhe 2.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

<b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b>	<p>Më pas vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit rajonet kulturore: Kur një hapësirë e caktuar rajonizohet duke u bazuar në veçoritë kulturore të saj, rajoni i formuar quhet rajon kulturor. <i>Rajonet kulturore</i> janë të ndryshme. Disa nga elementet bazë mbi të cilat ato krijohen, janë: grupet shoqërore, gjuha, besimi fetar dhe traditat. <i>Rajonet kulturore sipas grupeve shoqërore</i>. Rajonizimit që mund të bëhen mbi bazën e ndryshimeve kulturore apo strukturore që pësojnë grupet shoqërore janë të natyrave të ndryshme... Ftohen nxënësit të shohin dhe të diskutojnë mbi modelet e paraqitura në tekst.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

### ➤ Tema mësimore: I.3 Rajonet kulturore (vazhdim)

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: IV</b>	<b>KLASA: VIII</b>
<b>Nëntematika I: Rajonet dhe rajonizimi</b>		<b>Tema mësimore: I.3 Rajonet kulturore (vazhdim)</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.</li><li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi llojet e rajoneve.</li></ul>			
<b><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Prezanton dhe komunikon përmes hartës së botës shpërndarjen hapësinore të besimeve më të mëdha fetare dhe gjuhëve kryesore.</li></ul>			
<b><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.</li></ul>			
<b><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.</li></ul>			
<b><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ndan mendimet në grup.</li></ul>			

<p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tipat e rajoneve.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë. Prezanton dhe komunikon përmes hartës së botës shpërndarjen hapësinore të besimeve më të mëdha fetare dhe gjuhëve kryesore.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi interpreton veçoritë që i dallon secilin prej tyre.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvlerësimit midis vendeve dhe rajoneve.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvlerësimit midis vendeve dhe rajoneve. Prezanton dhe komunikon përmes hartës së botës shpërndarjen hapësinore të besimeve më të mëdha fetare dhe gjuhëve kryesore.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> rajone kulturore sipas gjuhës, rajone kulturore sipas traditave, rajone kulturore sipas besimeve fetare</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p><b>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</b></p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: a. Ç'është rajoni dhe veçoritë e rajoneve</p>
	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 në tekst: Diskutojmë: <i>Bazuar në njohuritë që keni, evidentoni disa veçori të gjuhës, besimit dhe traditave të popullit shqiptar. Rajonizoni hapësirën e Republikës së Shqipërisë (referojuni hartës së Shqipërisë të paraqitur në klasë) duke u bazuar në dialektet gjuhësore, traditat, veshjet popullore dhe në besimet fetare.</i> Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë, interpretojnë...</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë rajonet kulturore sipas gjuhës: Për shumë studiues, <i>gjuha</i> është guri themelor i kulturës. Pa gjuhën, njerëzit nuk do të ishin në gjendje të shprehnin mendimet, ndjenjat dhe njohuritë e tyre, dhe as nuk do të mund t'i përcillnin ato te brezat e rinj. Çdo kulturë ndërtohet në bazë të gjuhës përkatëse, megjithëse jo të gjitha e kanë të zhvilluar formën e shkruar të saj.</p> <p>Pra, duke qenë se një numër i madh gjuhësh kanë mbetur në nivelin e një gjuhe të folur dhe jo të shkruar, rajonizimi i të gjitha gjuhëve në shkallë botërore është tepër i vështirë. Një faktor tjetër që e vështirëson këtë proces është numri i madh i dialekteve gjuhësore që fliten në vende të ndryshme. Gjithsesi, një mënyrë e përshtatshme për rajonizimin e familjeve të gjuhëve kryesore botërore është pema gjuhësore. Mësuesi/ja fton nxënësit të interpretojnë hartën e figurës 1.</p> <p>Më pas i fton nxënësit të japin dhe të interpretojnë modele të ngjashme.</p> <p>Nxënësit diskutojnë dhe përshkruajnë...</p> <p>Mësuesja vazhdon të trajtojë Rajonet kulturore sipas traditave: <i>Tradita</i> është një element kulturor që përfshin mënyrën e të jetuarit, sjelljes në familje dhe në shoqëri, të organizimit të veprimtarive të ndryshme në jetën e përditshme etj. Bazuar në traditat e tyre, vendet mund të përfshihen në rajonizime të ndryshme.</p> <p>Traditat trashëgoohen nga njëri brez në tjetrin. Ato janë të lidhura ngushtë me mjedisin ku jetojnë njerëzit. Për shembull, mënyra e të ushqyerit në vendet e Evropës Mesdhetare dallon shumë nga ajo e popujve që jetojnë në veri të Kanadasë apo në Malajzi, për shkak të kushteve të ndryshme fiziko-gjeografike që ato kanë. Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë hartën e figurës 3.</p> <p>Më pas i fton nxënësit të japin dhe të interpretojnë modele të ngjashme.</p> <p>Mësuesja vazhdon të trajtojë rajonet kulturore sipas besimeve fetare:</p> <p><i>Besimet fetare</i> janë pjesë e kulturës së popujve. Nëpërmjet riteve të ndryshme që praktikojnë, popujt shprehin perceptimet dhe qëndrimet e tyre ndaj dukurive natyrore dhe atyre sociale. Gjatë procesit të zhvillimit të tyre, besimet fetare kanë njohur dy faza. Faza e parë është e lidhur ngushtë me besimet pagane, të cilat bazoheshin te shpirtëzimi i objekteve të natyrës, ndërsa faza e dytë ka</p>
---	---



	<p>të bëjë me besimet e kultivuara, që u përcillen njerëzve nëpërmjet predikimeve nga misionarët e feve të ndryshme. Shpërndarja gjeografike e këtyre besimeve përcakton edhe një rajonizim tjetër të hapësirës botërore. Fton nxënësit të interpretojnë hartën e figurës 4. Më pas i fton nxënësit të japin dhe të interpretojnë modele të ngjashme.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 4 dhe 5 të rubrika “Mburo një pikëpamje”.</p>
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## ➤ Tema mësimore: I.4 Rajonet demografike

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: IV	KLASA: VIII
Nëntematika I: Rajonet dhe rajonizimi		Tema mësimore: I.4 Rajonet demografike	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.</li><li>Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi rajonet demografike.</li></ul>			
<b><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Identifikon llojet e rajoneve demografike në botë.</li></ul>			
<b><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.</li><li>Interpreton grafikë, harta etj., që paraqesin dinamikën e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.</li></ul>			
<b><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.</li></ul>			
<b><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Ndan mendimet në grup.</li></ul>			
<b><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.</li></ul>			
<b><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>Interpreton grafikë, diagrame etj., që përshkruajnë dinamikën e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.</li></ul>			

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b> <b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi identifikon tipat kryesorë të rajoneve demografike në botë. Përshkuan llojet e tyre. <b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi interpreton veçoritë që i dallon secilin prej tyre. <b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvlerësive midis vendeve dhe rajoneve.	
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja lokalizon në hartë dhe interpreton rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë. Interpretet grafikë, diagrame etj., që përshkruajnë dinamikën e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.	<b>Fjalët kyçe:</b> dinamika e popullsisë botërore, rajonizimi i botës sipas dendësisë së popullsisë
<b>Burimet:</b> Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
<b>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</b>	
<b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>	Nxënësit dinë: a. ç'është rajoni dhe veçoritë e rajoneve
	<b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin I.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). <b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I : Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin I.4 në tekst: Diskutojmë: <i>Bazuar në njohuritë tuaja dhe në informacionet e marra nga burime të ndryshme, përshkruani se si është shpërndarë popullsia në vendin tonë (zonat me dendësi më të madhe dhe ato me dendësi më të ulët). Referoju hartës së Shqipërisë të paraqitur në klasë dhe rajonizo hapësirën e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në dendësinë e popullsisë.</i> Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë, interpretojnë...  <b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b> Mësuesi/ja vazhdon: Popullsia e botës është rreth 7,3 miliardë banorë. Ajo ka pësuar vazhdimisht ndryshime në numër dhe në strukturë, pasi është ndikuar në mënyrë

<b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b>	<p>të përhershme nga veprimi i shumë faktorëve, siç janë ata natyrorë, historiko-shoqërorë, ekonomikë, demografikë etj. Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun e figurës 1. Nxënësit diskutojnë dhe përshkruajnë...</p> <p>Mësuesja vazhdon të trajtojë <i>faktorët natyrorë, historiko-shoqërorë, ekonomikë, demografikë</i>.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin mbi rajonizimin e botës sipas dendësisë së popullsisë dhe të interpretojnë hartat 4,6,7 dhe tabelën 5.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 te rubrika “Radha jote”.</p>
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## ➡ Tema mësimore: I.5 Rajonet ekonomike

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: IV	KLASA: VIII
Nëntematika I: Rajonet dhe rajonizimi		Tema mësimore: I.5 Rajonet ekonomike	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Sjell shembuj të bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve në aspektin ekonomik, politik, kulturor, mjedisor etj.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)**

- Bën dallimin ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë (shoqëruar me interpretimin në hartë);

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (harta, foto, revista ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e diskutimeve të shembujve të përdorur në klasë.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si,?), organizon mendimet e veta dhe vlerëson përparimin deri në zgjidhjen e duhur.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)**

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit/diskutimeve të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

- Nxënësi shpjegon qartë mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe evidenton pasojat gjeografike që rrjedhin prej tij.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

- Nxënësi vlerëson dhe komunikon me të tjerët rolin e këtij rrotullimi.

**3. Marrja e vendimeve**

- Nxënësi bën dallimin ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë (shoqëruar me interpretimin në hartë).
- Sjell shembuj të bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve në aspektin ekonomik, politik, kulturor, mjedisor etj.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:**

Nxënësi bën dallimin ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë (shoqëruar me interpretimin në hartë);  
Sjell shembuj të bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve në aspektin ekonomik, politik, kulturor, mjedisor etj.

**Fjalët kyçe:** rajone ekonomike, bashkëveprimi dhe ndërvarësia midis rajoneve, rajonet gjeografike të botës

**Burimet:** Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, TIK.

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve**

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Nxënësit dinë:

a. Ç'është rajoni dhe veçoritë e rajoneve

**Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

**Veprimet në situatë**

**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>I.5 në tekst - Diskutojmë: <i>Rajone të ndryshme në botë bashkëpunojnë midis tyre në disa aspekte. Bazuar në informacionet e marra në burime të ndryshme, sillni disa shembuj të bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë midis rajoneve. Nxënësit japin përgjigjet e tyre.</i></p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesja orienton nxënësit të shohin figurën 1 dhe i fton ata ta përshkruajnë atë.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e tekstit: Vendet në botë paraqesin nivele të ndryshme zhvillimi ekonomik, për shkak të specifikave të kushteve natyrore, ndikimit të faktorëve historiko-shoqërorë, organizimit politik të territorit, politikave ekonomike që ndjekin, zhvillimit të teknologjisë etj. Vendet që kanë veçori të njëjta ose të përafërta në zhvillimin ekonomik të tyre mund të grupohen në <i>rajone ekonomike</i>. Bazuar në nivelin e zhvillimit ekonomik në shkallë botërore, vendet ndahen në: <i>vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim</i>.</p> <p>Bazuar në figurën 1, mësuesja së bashku me nxënësit, analizon ndryshimet midis <i>vende të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim...</i></p> <p>Më pas mësuesi/ja fton nxënësit që bazuar në njohuritë e marra në Gjeografinë 6, të diskutojnë (përmes shembujve) rreth bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve. Në vijim, mësuesja diskuton me nxënësit rreth ndryshimeve midis rajoneve, ekonomike, fizike e demografike dhe atyre gjeografike.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit diskutojnë rreth ushtrimeve 1, 2, 3 dhe 4.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ➤ Punë praktike 1

**Tema: Llojet e rajoneve**

**Rezultatet e të nxënës**

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- plotëson në hartë (emërton dhe ngjyros) dhe evidenton disa rajone fizike, kulturore, ekonomike dhe demografike;
- plotëson në hartë (emërton dhe ngjyros) dhe evidenton rajonet gjeografike të botës;
- vlerëson dhe respekton diversitetin social, kulturor dhe mjedisor të këtyre rajoneve;
- shfaq kureshtje për vendet dhe rajonet e botës, si dhe vlerëson bashkëpunimin ndërmjet tyre.

**Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:** 45 minuta; në klasë.

**Materialet burimore:**

teksti mësimor, informacione dhe harta të gjetura në internet apo në enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

**Mjetet e punës:**

harta-skicë, atlas gjeografik, teksti mësimor, laps, rapidograf, lapsa me ngjyrë/lapustila.

**Metodologjia që do të përdoret:**

punë individuale (ngjyrosje dhe emërtim i hartës-skicë), punë në grupe (diskutim, shkëmbim mendimesh).

**Puna përgatitore:**

Për realizimin e kësaj pune praktike mbështetuni në njohuritë e marra nga teksti mësimor për rajonet, veçoritë e tyre dhe për kriteret e rajonizimit. Hulumtoni në burime të ndryshme (internet, enciklopedi etj.) për llojet e rajoneve dhe specifikat e tyre.

**Hapat që do të ndiqni gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:**

1. Përcaktoni (emërtoni dhe ngjyrosni) në hartën-skicë rajonet fizike, kulturore, ekonomike dhe demografike.
2. Përcaktoni (emërtoni dhe ngjyrosni) në hartën-skicë rajonet gjeografike të botës.
3. Përshkruani veçoritë e rajoneve.

Shënim: Për realizimin e punës praktike 1, plotëso hartat-skicë 1-5 në fund të librit.

## Nëntematika II: Evropa (32 orë)

**Tema mësimore: 2.1**

**Pozita gjeografike e rajonit të Evropës**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: IV	KLASA: VIII
Nëntematika II: Evropa	Tema mësimore: 2.1 Pozita gjeografike e rajonit të Evropës	<b>Situata e të nxënës.</b> Në hartën fiziko-gjeografike të Evropës shohim që rajoni i Evropës është një gadishull i madh, i përbërë nga shumë gadishuj të vegjël. Bazuar në njohuritë tuaja, përcaktoni pozitën gjeografike dhe renditni disa nga ishujt e gadishujt kryesorë të tij.	

## **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

### **1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm:
  - Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit mbi: rajonet si koncepte organizuese; konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve; tipat kryesorë të rajoneve në botë; rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë; pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të Evropës, dinamikën e popullsisë së Evropës; larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane, veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës perëndimore, Evropës veriore dhe Evropës ishullore.

### **2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)**

- Interpretin me ndihmën e hartës pozitën gjeografike të Evropës, rolin e saj në marrëdhënien dhe lidhjet me rajonet e tjera.

### **3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (harta, foto, revista ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e diskutimeve të shembujve të përdorur në klasë.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si?), organizon mendimet e veta dhe vlerëson përparimin deri në zgjidhjen e duhur.

### **4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.

### **5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)**

- Ndan mendimet në grup.

### **6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit/diskutimeve të grupit.

### **7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.

## **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës**

### **1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

- Interpretin me ndihmën e hartës pozitën gjeografike të Evropës, rolin e saj në marrëdhënien dhe lidhjet me rajonet e tjera.

### **2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

- Identifikon dhe interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.

### **3. Marrja e vendimeve**

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton me ndihmën e hartës pozitën gjeografike të Evropës, rolin e saj në marrëdhënien dhe lidhjet me rajonet e tjera.</li> <li>• Identifikon dhe interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> pozita gjeografike, kufiri lindor i rajonit</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, TIK.</p>
<p><b>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Metoda me në qendër nxënësin</b>  <b>Struktura e mësimit</b>  <b>ERR</b>  <b>Veprimtaritë e nxënësit:</b>  <b>Punojnë</b>  <b>Mësojnë</b>  <b>Diskutojnë</b></p>	
<p><b>Organizimi i orës së mësimit.</b>  <b>Evokim:</b> Stuhi mendimesh          U tërheq vëmendjen e nxënësve për temën e mësimit, çështjet kryesore duke krijuar, një stuhi mendimesh me pyetjen: “Çfarë është Evropa?”. Nxënësit përgjigjen duke u bazuar në njohuritë që ata kanë. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.</p> <div data-bbox="293 1147 1108 1591" data-label="Diagram"> </div>	



### Realizimi i kuptimit: Kllaster

Me ane të kllasterit bëje shpjegimin e mësimit duke u bazuar në fjalët kyçe të mësimit.

pozita gjeografike  
Gadishull  
Veri oqeani i Ngrirë i veriut  
jug Deti Mesdhe  
lindje rajoni i Ruisë  
perëndim Oqeani Atlantik

Pozita gjeografike e rajonit  
të Evropës.

kufiri lindor i rajonit  
malet urale në varësi të zhvillimeve ekonomike,  
politike e sociale.

### Reflektimi: Punë në grup

Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë rreth ushtrimeve të rubrikës Radha jote.


<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## ➡ Tema mësimore: 2.2

### Kushtet natyrore të rajonit të Evropës


<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: IV</b>	<b>KLASA: VIII</b>
--	-----------------------------	--------------------	--------------------

<p><b>Nëntematika II:</b> <b>Evropa</b></p>	<p><b>Tema mësimore: 2.2 Kushtet natyrore të rajonit të Evropës</b></p>	<p><b>Situata e të nxënit.</b> Duke u bazuar në hartën fiziko-gjeografike të rajonit të Evropës, përshkruani format e relievit dhe klimën që e karakterizon, si dhe evidentoni disa prej lumenjve kryesorë që e përshkojnë këtë rajon.</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.             <ul style="list-style-type: none"> <li>Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit mbi: rajonet si koncepte organizuese; konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve; tipat kryesorë të rajoneve në botë; rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë; pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të Evropës, dinamikën e popullsisë së Evropës; larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane, veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës perëndimore, Evropës veriore dhe Evropës ishullore.</li> </ul> </li> </ul> <p><b><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon dhe interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</li> </ul> <p><b><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></b></p> <p>Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve, duke përdorur dhe ndërtuar hartat, atlaset, enciklopeditë, anketat, dhe të dhëna të tjera për të: analizuar pozitën gjeografike të Evropës, rolin e saj në marrëdhënien dhe lidhjet me rajonet e tjera; njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</p> <p><b><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.</li> </ul> <p><b><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndan mendimet në grup.</li> </ul>		

<p><b>6. Kompetenca qytetare</b> (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit/diskutimeve të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale</b> (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</li> </ul> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përkshuan dhe vlerëson njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</li> </ul> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësi interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon dhe interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</li> <li>Lokalizon dhe përzgjedh informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.).</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> reliev, hidrografia, klima, bota e gjallë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, TIK.</p>
<p><b>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</b></p> <p><b>Metoda me në qendër nxënësin</b></p> <p><b>Struktura e mësimi</b></p> <p><b>ERR</b></p> <p><b>Veprimtaritë e nxënësit:</b></p> <p><b>Punojnë</b></p> <p><b>Mësojnë</b></p> <p><b>Diskutojnë</b></p>	
<p><b>Organizimi i orës së mësimi.</b></p> <p><b>Evokim:</b> Stuhi mendimesh</p> <p>U tërheq vëmendjen e nxënësve për temën e mësimi, çështjet kryesore duke krijuar, një stuhi mendimesh me pyetjen: “Çfarë janë kushtet natyrore?”. Nxënësit përgjigjen duke u bazuar në njohuritë që ata kanë. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.</p> <div style="text-align: center;">  </div>	

**Realizimi i kuptimit: Harta e të pyeturit**

Nëpërmjet hartës së të pyeturit bëjë shpjegimin e mësimit duke u bazuar në pyetjet e njëpasnjëshme.

**Reflektimi: Rrjeti i diskutimit**

Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë për çështjen “A ka Evropa një rëndësi të madhe social-ekonomike në shpërndarjen gjeografike të kushteve të saj natyrore”, duke u bazuar në argumentin Pro dhe Kundër.

<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## ➞ Tema mësimore: 2.3 Trashëgimia historike dhe kulturore

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: IV	KLASA: VIII
<b>Nëntematika II: Evropa</b>	<b>Tema mësimore: 2.3 Trashëgimia historike dhe kulturore</b>	<b>Situata e të nxënit</b> Nga historia keni mësuar mbi qytetërimin e hershëm grek dhe atë romak. Keni mësuar gjithashtu edhe mbi pushtimet otomane në Evropë. Evidentoni disa nga ndikimet kryesore të qytetërimit grek dhe romak në trashëgiminë kulturore të rajonit dhe më gjerë, si dhe për ndikimin që pati pushtimi otoman në Evropë.	

## **Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe**

### **1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm:

- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit mbi; rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë; pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të Evropës, dinamikën e popullsisë së Evropës; larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane, veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës Perëndimore, Evropës Veriore dhe Evropës Ishullore.

### **2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)**

- Krahason dhe gjen ndryshimet e ngjashmëritë e kulturave në Evropë, duke sjellë shembuj të respektimit të diversitetit kulturor.

### **3. Kompetenca e të nxënës (Nxënësi mëson për të nxënë)**

